



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[19.04.2024]

Drejtuar: **JUBICA.sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z.Ndoc Kulla, me NUIS K26529001I. Adresa: Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108 , Shkoder.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-98654-03-18-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: **”Permiresimi i Sinjalistikes Horizontale dhe Vertikale në segmentet kryesore, Bashkia Shkoder”**

Fondi limit **41,309,221(Dyzet e njemilion e treqind e nentemije e dyqind e njetzet e nje)** lekë pa tvsh

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [25.03.2024] [16]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **RSM COMPANY** shpk me NIPT 810802422 Shoqeria meme e **Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h** përfaqësuar nga administratori zj. Elida Kola me NUIS L04803001U
Vlera **28,953,815** (Njetzet e tetemilion e nenteqind e pesedhjetete e tre mije e teteqind e pesembedhjetete) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik **JUBICA.sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z.Ndoc Kulla, me NUIS K26529001I.
Vlera **37,950,000** (Tridhjetete e shtatemilion e nenteqind e pesedhjetemije) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik **I.D.K - KONSTRUKSION sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z. Gramos Dalipi, me NIPT K51408016J.
Vlera **40,276,490** (Dyzetmilion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e nentëdhjetë) lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik "METEO"sh.p.k përfaqësuar nga administratori z. Erind Bengu, me NUIS L26310801C.
Vlera **40,772,201** (Dyzetmilion e shtateqind e shtatedhjetë e dymijë e dyqind e nje) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik " DELTAREX"sh.p.k përfaqësuar nga administratori z. Artur Bisha, me NUIS L92314031R.
Vlera **40,443,036** (Dyzetmilion e katerqind e dyzet e tremijë e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. U skualifikua operatori ekonomik **RSM COMPANY**shpk me NIPT 810802422 Shoqëria meme e **Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h** me NUIS L04803001U, për këto arsye:

Nuk ploteson piken 2.3.2 të DST, kapaciteti teknik ku kërkohej 2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

NP-12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

NS-6/ B (Sinjalistika rrugore jondriçuese)

NS-18/A (Punime topogjeodezike)

Operatori ekonomik “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., ka paraqitur licencën NZ.7055/11, nga ku rezulton se nuk disponon nivelin e kategorisë përkatëse për punimet speciale të ndërtimit. Konkretisht ofertuesi për zbatimin e punimeve objekt kontrate nuk disponon nivelin e kategorisë NS-6/ B (Sinjalistika rrugore jondriçuese) por disponon vetëm nivelin e kategorisë NS-6/ A (Sinjalistika rrugore jondriçuese) por disponon

Per plotësimin e kriterit për nivelin të kategorisë NS-6/ B (Sinjalistika rrugore jondriçuese) operatori ekonomik “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h. është mbështetur në kapacitetin e subjektit Desaret Company sh.p.k e cila deklaron se mbështet operatorin ekonomik “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h me piken e licences NS-6/ B (Sinjalistika rrugore jondriçuese)

Kjo gjë bie ndesh me:

Nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”I ndryshuar ku përcaktohet se:

- Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohej aftësi e tillë. Nenin 90, “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohej një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër

Sic është e percaktuar me lart legjislacioni mbi prokurimin public nuk parashikon transferimin e pikave te licences apo nivelit te kategorive perkatese nga nje subjekt tek nje subject tjetër nese subjekti qe zoteron piken e licences ne kete rast Desaret Company sh.p.k nuk I merr persiper ti kryeje vete ato punime qe perfshihen ne kete pike licence gje te cilen ky subject nuk e ka deklaruar se do marri persiper qe keto punime do ti realizoje vete.

Gjithashtu duke iu referuar ligjit sectorial te fushes se punimeve te ndertimit e konkretisht referuar parashikimeve të shkronjës “a”, pika 1, Kreu III të VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” I ndryshuar citojme:

Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

-Kapacitetet financiare

KREU VI DOKUMENTET QË SHOQËROJNË APLIKIMIN PËR LICENCË PROFESIONALE, NDRYSHIME DHE PËRDITËSIME

Pika 8. Ndryshimi i shkallës së klasifikimit për kategoritë e licencës që disponon:

a) Kërkesa për ndryshim të shkallës së klasifikimit shqyrtohet në rastet kur:

I. Ndryshohen drejtuesit teknikë gjë që çon në llogaritjen e pikësimit për drejtuesin teknik të ri apo shtimin/heqjen e nivelit, si edhe kategorisë që përfitohej si rezultat i këtij drejtuesi. Në këtë rast plotësohen dokumentet sipas kërkesave të pikës 3.

II. Kërkohet rritje nga vetë shoqëria me të njëjtët drejtues teknikë si rezultat i punimeve të ngjashme që ka kryer ndërkohë, rritjes së eksperiencës së drejtuesve teknikë si në vite, ashtu edhe në punë.

b) Dokumentet që duhet të plotësojë shoqëria, për këtë rast janë, kërkesa sipas formularit të përcaktuar në lidhjen nr.6, shoqëruar edhe me:

I. Informacion në lidhje me punët e kryera gjatë vitit/viteve të fundit, nisur nga aplikimi paraardhës. Informacioni shoqërohet me: - Kopje të situacioneve të punimeve të likuiduara, të vulosura nga entet publike shtetërore apo private, (origjinale ose kopje të noterizuara); - Kopje bilancesh (origjinale ose kopje të noterizuara); - Akte kolaudimi apo marrjes në dorëzim të objekteve (origjinale ose kopje të noterizuara); Ky informacion vlen edhe për pikësimin e eksperiencës së drejtuesit/drejtuesve teknikë ekzistues

NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998, “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TËNDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR, neni 3

1. “Zbatues i punimeve” është personi juridik, vendës apo i huaj, i licencuar për të ushtruar veprimtari në zbatimin e punimeve të ndërtimit, sipas klasifikimeve dhe kategorive të

punimeve që ka të përcaktuar në licencë, i cili është përgjegjës për realizimin e punimeve të ndërtimit, nëpërputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik

“Neni 8

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.

Sic parashikon legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe zbatimin e tyre një shoqëri për të kryer punime ndërtimi duhet të ketë piken dhe nivelin e licencës profesionale të zbatimit.

Shoqëria Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., nuk është e pajisur me këto nivel në licencën e saj konkretisht nivelin B që si vlerë të punimeve është nga 21.000.000-50.000.000 dhe në të tilla kushte nuk mund të marrin pjesë për zbatimin e punimeve të një objekti ku niveli i licencës përkatëse që kërkohej NS-6/ B (Sinjalistika rrugore jondriçuese) dhe përben pothuajse 90% të vlerës totale të punimeve që do të kryhen.

Gjithashtu referuar legjislacionit të fushës së zbatimit të punimeve të ndërtimit për të përfituar rritje të nivelit të licencës nga niveli A në B e më tej ligji parashikon një sërë procedurash.

2-U skualifikuan operatori ekonomik "METEO"sh.p.k, me NUIS L26310801C, për këto arsye:

-Nuk keni paraqitur formularin e sigurimit të ofertës sipas shtojcës 3

-Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 keni deklaruar se keni 4 punonjës nga 50 që kërkohej

- Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit siç është shtojcës 8 nuk keni deklaruar se dispononi

1-Automjet Vijëzimi për Boje Termoplastike (APV me leje qarkullimi) me kapacitet minimumi 4 tone

2-Makinë vijëzimi me bojë Bikomponente me kapacitet minimumi 400 liter

3- Kamion me vinç të integruar

-Nuk keni paraqitur punime të ngjashme me objektin e prokurimit

-Nuk keni paraqitur vetdeklarimet e inxhinierëve të ndërtimit, topograf dhe mjedisit

3-U skualifikuan operatori ekonomik " DELTAREX"sh.p.k, me NUIS L92314031R, për këto arsye:

1-Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 nuk keni deklaruar nr. E punonjësve që dispononi

2-Nuk keni paraqitur dëshmi për punime të ngjashme pasi nuk është paraqitur Formulari I vlerësimit për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 nga Autoriteti Kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: **JUBICA.sh.p.k** përfaqësuar nga administratori z.Ndoc Kulla, me NUIS K26529001I, Adresa: Rruga Luigj Gurakuqi, Kukle, nr 108 , Shkoder se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej me ofertën

ekonomike me **37,950,000** (Tridhjete e shtatemilion e nenteqind e pesdhjetemije) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Onid BEJLERI